

Cilat janë pritshmërit që vullnetarët duhet të kenë prej meje?

Në Gjermani sjellja kulturore me kohën është shumë më pak elastike se në shoqëri të tjera. Kjo do të thotë, që përpikmëria dhe besueshmëria janë shumë të rëndësishme për shumicën e vullnetarëve. Nëse përpara një takimi me një vullnetarë i'u del diçka e paparashikuar ose kur ju ndryshoni mendjen mbasi keni rënë dakord, atëherë vullnetarë presin prej jush, që ju t'i informoni ata në kohë. Nëse ju nuk e dëshironi më një mbështetje ose dëshironi një ndihmë tjetër, ose kur ju keni problem me një sjellje të caktuar atëherë prej jush pritet, që ju t'a bëni të ditur këtë/ ta thoni hapur. Pjesa me e madhe e njerëzve në Gjermani nuk e perceptojnë këtë si të pasjellshme, për kundraz, kjo është e ndershme dhe përbën një shenjë mirëbesimi.

Për angazhimin dhe ndihmën që ofrojnë, vullnetarëve nuk i'u lejohet të marrin para ose dhurata me vlera të mëdha prej jush. Por ata ndihen shumë të lumtur, kur ju i falënderoni për atë që bëjnë qoftë edhe me fjalë. Në rastin kur vullnetarët e ndërpresin ndihmën e tyre, kjo mund të ndodh për shumë arsye. Ju nuk duhet ta shikoni këtë si një refuzim personal.

Cilat janë organizatat që ekzistojnë?

Në Gjermani ekzistojnë një sër organizatash mirbërse, në të cilat angazhohen shumë vullnetarë. Organizata më të mëdha janë të ashtuquajturat „Wohlfahrtsverbände“, shoqata bamirësie. Njëra prej tyre është dioqeza, shërbimi social i kishës evangjelike. Qendra këshilluese të dioqezës mund t'i gjeni në internet në adresën e më poshtëme: www.diakonie.de/Broschuere_Migration-2015.pdf

Këto shoqata në shumicën e prefekturave dhe qarqeve kanë qendra për këshillimin e azilantëve në mënyrë profesionale dhe ofrojnë pjesërisht banesa në qendra të përbashkëta strehimi. Në këto shoqata janë të angazhuar gjithashtu shumë vullnetarë, të cilët organizojnë shumë projekte sociale në mbështetje të të shpërngulurve. Përveç këtyre shoqatave ekzistojnë edhe iniciativa dhe projekte të tjera, të cilat nuk janë pjesë e organizatave të mëdha. Shumë prej këtyre iniciativave quhen edhe iniciativa të mirseardhjes. Në këto iniciativa njerzit bashkohen rastësisht për të ofruar ndihmë për të shpërngulurit. Gjithashtu ka edhe njerëz, të cilët ofrojnë ndihmë në mënyrë individuale.

Kontakt dhe Informacion

Diakonie Deutschland – Evangelischer Bundesverband
Evangelisches Werk für Diakonie und Entwicklung e. V.
Caroline-Michaelis-Straße 1
10115 Berlin

Përgjegjës

Lorenz Hoffmann
Kordinimi, kualifikimi dhe subvencionimi për mbështetjen vullnetare të të shpërngulurve
Qendra për migracionin dhe shërbimet sociale

Informacion

Mirjam Appel
Telefon: +49 30 652 11-1975
Telefaks: +49 30 652 11-3975
mirjam.appel@diakonie.de
www.diakonie.de

Subvencionohet dhe promovohet prej:



Ç'farë janë vullnetarët / angazhuesit me dëshirë?

Shërbimi kishtar
për njerëzit

Informacion

Dhjetor 2016

Ç'farë janë vullnetarët/ angazhuesit me dëshirë?

Në Gjermani është detyra e shtetit, që njerëzve të shpërngulur t'i mundësojë shërbime të caktuara. Në këto shërbime bëjnë pjesë midis të tjerash edhe strehimi dhe sigurimi i ushqimit ose vënija në dispozicion e një shume lekësh, me qëllim që ç'do kush të mund t'i siguroj vetë këto shërbime. Gjithashtu shteti është përgjegjës për shërbimet sociale në qendrat e strehimit, për shërbimin bazë shëndetësor si dhe për procesin e azilkërkimit, nëse ky proces zhvillohet në Gjermani. Në procesin mbi kërkesën për azil do të sqarohet, nëse ju do të merreni në mbrojtje në Gjermani dhe nëse mund të qëndroni këtu.

Në qendrat e azilantëve ka shumë më pak punonjës social nga sa është e nevojshme. Për shembull, në qendrat ose kabanonet e përbashkëta të strehimi ka një puntore sociale për 120 ose edhe me shumë njerëz. Kjo punëtoje nuk mund të bëjë ç'do gjë që është e nevojshme. Për shumicë e të shpërngulurve nuk ka kurse për mësimin e gjuhës gjermane dhe shumë pak mundësi, që këta të njihen e ambjentohen me vendin e ri dhe të bëhen pjesë e jetës shoqërore. Përkëthimet paguhen vetëm në raste të veçanta.

Shpesh herë njerëzit ofrojnë ndihmën e tyre duke u treguar solidar dhe të gatshëm për ndihmë. Të till persona quhen edhe vullnetarë, angazhues me dëshirë ose profesionist nderi. Këta persona angazhohen dhe ofrojnë ndihmë në kohën e tyre të lirë dhe për këtë ata nuk paguhen. Disa prej tyre madje janë vetë të shpërngulur ose prindrit e tyre kanë qenë të shpërngulur shumë kohë më parë. Arsyet se përse këta njerëz dëshirojnë t'i ndihmojnë juve janë nga më të ndryshmet. Por ju thjesht mund t'i pyesni vetë ata!

Ç'farë bëjnë angazhuesit vullnetar?

Ata ndihmojnë për shembull për mësimin e gjuhës gjermane ose shoqërojnë njerëzit e shpërngulur tek mjekët ose nëpër zyra të ndryshme. Disa prej tyre ndihmojnë, që ju të kuptoni letrat që merrni, ose që ju t'i drejtoni kërkesat tuaja në vendet e duhra ose si të gjeni një vend këshillimi për procesin e azilit apo si të gjeni një avokat. Disa të tjerë i'u mbështesin për gjat kërkimit të një shtëpie ose një vendi pune ose ndihmojnë fëmijët për të bërë detyrat e shtëpisë dhe organizojnë takime me banorët vendas. Gjithashtu ekzistojnë edhe shumë aktivitete të ndryshme kulturore dhe sportive, siç janë ato që zhvillohen nga shoqata të ndryshme. Përveç këtyre ka edhe shumë emigrantë dhe emigrante, të cilët jetojnë prej shumë kohësh në Gjermani dhe që angazhohen në mënyrë vullnetare. Kështu me kompetenzën e tyre gjuhësore që zotrojnë, ata ndihmojnë shpeshherë, për shembull si përkëthyes.

Normalisht që vullnetarët nuk janë punonjës të shërbimit social, por ata kanë profesione të tjera, kështu që edhe për ,ta janë shumë gjëra të reja: Ata nuk mund të zëvendësojnë mësuesin, doktorin apo avokatin dhe të ofrojnë shërbime avokatie. Por ata mund t'iu sqarojnë dhe t'iu tregojnë se si funksionojnë gjërat e jetës së përditëshme dhe ku mund të drejtoheni ju, kur i'u nevojiten sepcialistë të fushave përkatëse. Ata mund t'iu shoqërojnë ju nëpër zyra të ndryshme dhe në këtë mënyrë t'iu japin juve më shumë mbështetje dhe siguri. Kjo për ju do të thotë: Ju nuk do t'iu duhet t'i bëni të gjitha gjërat të vetëm. Por jeni ju ata që mbajnë gjithmonë përgjegjësinë. Vullnetarët duhet që t'iu ndihmojnë por ata nuk duhet të veprojnë në emrin tuaj. Për shembull, nëse një vullnetar i'u shoqëron ju përgjat intervistës për procesin e azilit, ju duhet që arsyet e shpërnguljes t'i parashtroni dhe t'i sqaroni vetë dhe jo vullnetari që i'u shoqëron. Këto janë çështjet tuaja personale dhe ju do t'iu duhet të merrni këshilla nga specialistë të fushave përkatëse. Vetëm në këtë mënyrë mund të merrni vendime të drejta dhe të vulltëshme për ju. Për veç kësaj ju duhet të merrni parasysh që: origjinalët e dokumentave personale ose letrave zyrtare mos t'i lëshoni anjë herë prej dorës. Si rrjedhojë është me interes për ju, të keni gjithmonë fotokopje të këtyre dokumentave. Këto fotokopje mund t'ua jepni vullnetarëve, që ata të kryejnë një telefonat, për shembull në një zyrë kur ju i'u luteni atyre për një gjë të tillë.

Vullnetarët mund t'iu sigurojnë ju informacione dhe të dhëna të cilat është vështirë t'i gjesht. Por shpeshherë korrniza e masave ligjore është kaq e ngushtë, sa që ata mund t'iu ndihmojnë vetëm në mënyrë të kushtëzuar/pjesërisht, për shembull përgjat kërkimit të një vendi pune ose një strehe banimi. Pyetjet mbi të drejtën e lejeqëndrimit ose të azilkërkimit, pra nëse ju mund të merreni në mbrojtje dhe të qëndroni në Gjermani, ju duhet ne çdo rast t'i adresoni tek specialistët përkatës.

Cilat janë pretendimet dhe të drejtat që ju mund të kërkonit?

Ju nuk keni të drejtën të pretendoni një shërbim ose ndihmë të caktuar prej vullnetarëve, siç ju mund të pretendoni prej njerëze, të cilët paguhen për punën e tyre. Kjo nënkupton gjithashtu se, askush nuk mund të garantojë ose të premtojë, se do të ketë mjaftueshëm vullnetarë për të gjithë të shpërngulurit. Por: edhe pse vullnetarët nuk paguhen për angazhimin e tyre, ju duhet të prisni prej tyre, që ata t'iu përmbahen gjërave për të cialt ju keni rënë dakort.

Pjesa më e madhe e vullnetarëve kanë një profesion dhe gjithashtu një familje. Kjo do të thotë, që koha e tyre është e kufizuar. Kështu që është e rekomandueshme, t'i pyesni që në fillim, se sa kohë kanë ata në dispozicion për t'iu ndihmuar ju.

Vullnetarët nuk duhet në asnjë rastë t'iu tregojnë njerëzve të tjerë, ato çfarë ju i'u keni treguar apo rrëfyer për vehten apo për të shpërngulur të tjerë. Por megjithatë kjo gjë ndodh shumë shpesh. Vetëm tek këshilluesit profesionistë dhe tek avokatët ligjor ju mund të keni sigurinë, se ato që ju i'u tregoni atyre nuk do t'iu thuhën njerëzve të tjerë, sepse kjo është pjesë e profesionit të tyre.

Më parë se një vullnetarë të bëjë diçka për ju, ai duhet t'iu pyes, nëse ju jeni dakord me atë që ai po bën për ju. Kërkoni mbështetje në rastin, kur midis jush dhe ndonjë vullnetari lind një konflikt, por mbi të gjitha ju duhet te kërkonit mbështetje, atëherë kur ju keni vështirësi komunikim. Ndoshta ju mund t'a zgjidhni ose sqaroni konfliktin bashkarisht? Por ju mundeni t'a përfundoni ndihmën që i'u është ofruar ose të ndërprisni çdo kontakt edhe nëse ju jeni shumë mirënjohës për ndihmen e ofruar deri më tani. Në një rast të till, do të ishte me vlerë, nëse ju n'a beni me dije arsyet që i'u çuan në këtë vendim.